



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.35/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Milosh Dimitrijevic, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Pejë, nga subjekti politik Lista Serbe, dega në Pejë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) për shkak të decertifikimit nga gara për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale 2017 si kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Pejë, në seancën e panelit të mbajtur me 25.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i Milosh Dimitrijevic, për anulimin e vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), me të cilin parashtruesi i apelit është decertifikuar si kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Pejë nga partia politike Lista Serbe për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datën 22.10.2017.

A r s y e t i m

Parashtruesi i apelit Milosh Dimitrijevic, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Pejë nga subjekti politik Lista Serbe me datën 22.09.2017, ka paraqitur një apel në PZAP, kundër vendimit të KQZ-së, me të cilin pretendon se KQZ-ja me datën 19.09.2017, e ka decertifikuar si kandidat nga lista e subjektit politik Lista Serbe për anëtar të Kuvendit Komunal në Pejë. Parashtruesi i apelit kërkon nga PZAP-i që të anulohet vendimi i KQZ-së lidhur me decertifikimin e tij sepse i njëjti thekson se vendimi i KQZ-së bie ndesh dhe shkel dispozitat kushtetuese të nenit 45 paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

KQZ-ja, në përgjigjen në ankesë ka theksuar, se në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Supreme Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e mbajtur me datën 22.09.2017, ka anuluar vendimet për decertifikim të kandidatëve. Kandidatët e decertifikuar janë kthyer në lista të kandidatëve për pjesëmarrje në zgjedhjet lokale që do të mbahen me 22.10.2017, e po ashtu ka anuluar edhe vendimet për certifikimin e kandidatëve të cilët i kanë zëvendësuar kandidatët e decertifikuar përveç atyre të cilët nuk kanë dëshiruar të kthehen në listën zgjedhore.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi të gjitha dëshmitë relevante, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerësoi lejueshmërinë e apelit dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 122 të LZP-së dhe nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015- Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të apelit se me rastin e marrjes së vendimit nga KQZ-ja, lidhur me decertifikimin e tij nga gara e listës së kandidatëve për anëtarë të kuvendit komunal në Pejë, ju është bërë e pa drejtë, Paneli vlerëson se pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj dhe si të tilla u refuzuan, sepse KQZ-ja me vendimin Nr.1741-2017 dhe Nr. 1745-2017, të gjithë kandidatët e decertifikuar i ka kthyer në lista të kandidatëve për pjesëmarrjen në zgjedhjet lokale që do të mbahen me 22.10.2017. Andaj duke u nisur nga kjo gjendje faktike Paneli vlerëson se parashtruesi i apelit nuk ka interes juridik në këtë çështje.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika b) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr. 35/2017 më datën 25.09.2017.



Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.